

TRACES OF WRITTEN ALBANIAN GJURMË TË SHQIPES SË SHKRUAR

Emine SHABANI¹, Remzije NUHIU²

^{1*} Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

² Department of English Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: emine.shabani@unite.edu.mk

Abstract

Language is the identity of a people, its spirit, its existence, its past, and its future! But for language to have longevity it must be written. This was the concern, desire, and anxiety of Albanian intellectuals, from the Renaissance to the Congress of Manastir, a time for which we have written evidence and arguments! Let us follow their journey and efforts for this divine mission. The Albanians, located on a land belt between two continents, experienced the fate of the clash of interests of the most powerful empires of the time, the Western-Roman and the Ottoman. An ark of ambitions from the most powerful empire of the east and a resistance mixed with fear and dread of the west is the word that describes the medieval political situation. In the midst of this catastrophe, the Albanians had to preserve their identity, language, and culture as the most ancient people in these lands.

The arrival of the Turks on the Illyrian Peninsula, which after their conquest will be called the Balkans, a land of honey and blood, changed many things in the life of the Albanians, including the taking hostage of Gjon Kastriot's sons as a form of security. A writing tradition had existed very early on, but it was already beginning to lose track, many literary and artistic works were destroyed, those that survived would later be discovered by scholars such as Nilo Borgja, who also published a study of excellent for the "Pericope of the Gospel" from the XIV century, with Greek letters and Albanian words. This tells us about a tradition of writing Albanian with Greek letters, in the south of Albania, such as Konstantin Kristoforidhi who wrote the Dictionary of the Albanian language, the Hunt of the Highlanders, the Alphabet, etc.

Keywords: *Old Albanian Language, identity, Middle Age, Renaissance.*

Përmbledhje

Gjuha është identiteti i një populli, fryma, ekzistenca, e kaluara dhe e ardhmja e tij! Por gjuha që të ketë jetëgjatësi duhet të shkruhet. Kjo ishte brenga, dëshira dhe ankthi i intelektualëve shqiptarë, që nga renesanca e deri në Kongresin e Manastirit kohë kjo për të cilën kemi dëshmi dhe argumente të shkruara! Le të ndjekim rrugëtimin dhe përpjekjet e tyre për këtë mision hyjnor. Shqiptarët të ndodhur në një rrip tokësor mes dy kontinentesh, përjetuan fatin e përplasjes së interesave të perandorive më të fuqishme të kohës, asaj perëndimore-romake dhe otomane. Një arkë ambiciesh nga perandoria më e fuqishme e lindjes dhe një rezistencë e përzier me droje e frikë e perëndimit, është fjala që e përshkruan gjendjen politike mesjetare. Mes kësaj katrahure shqiptarët duhej të ruanin identitetin, gjuhën e kulturën si popull më i lashtë në këto troje.

Ardhja e turqve në Gadishullin Ilirik, të cilin pasi e pushtojnë do ta quajnë Ballkan, vend i mjalit dhe gjakut, ndryshoi shumëçka nga jeta e shqiptarëve duke përfshirë këtu marrjen peng të djemve të Gjon Kastriotit si një formë sigurie. Një traditë shkrimi kishte ekzistuar shumë herët, por ajo filloi tashmë t'i humbasë gjurmët, shumë vepra letrare e të artit u shkatërruan, ato që mbijetuan, më vonë do të zbulohen nga studiuesit si, Nilo Borgja, i cili botoi edhe një studim të shkëlqyer për "Perikopenë e Ungjillit" nga shekulli XIV, me shkronja greke e fjalë shqipe. Kjo na tregon për një traditë të shkrimit shqip me germa greke, në jug të Shqipërisë, sikurse Konstantin Kristoforidhi që e shkroi Fjalorin e gjuhës shqipe, Gjahun e malësorëve, Alfavitarin, etj.

Fjalët kyçe: *Gjuha e vjetër shqipe, identiteti, mesjeta, renesanca.*

Hyrje

Shkrimtari i njohur arbëresh, Zef Skiroi duke ndjekur gjurmët e studiuesve të mëhershëm, pati fatin që në Arkivin Sekret të Vatikanit, të zbulonte një dorëshkrim nga viti 1210 me autor Teodor Shkodranin. Dorëshkrimi përbëhet nga 208 fletë i ndarë në tre kapituj me përmbajtje teologjike filozofike dhe historike. Ndërsa në Arkivin e Dubrovnikut është zbuluar një dokument që daton nga 14 korriku i vitit 1284 ku thuhet: “Dëgjova një zë në mal që thërriste në gjuhën shqipe” (Audiui unam vocem clamantem in monte in lingua albanesca). Indoeuropean Language, (Kapovic, 2017:554).

Dëshmi tjetër është edhe dokumenti i shkruar nga një autor anonim, që duket të ketë qenë prift i urdhrit domenikan, i cili në vitin 1308, gjatë udhëtimit nëpër Ballkan, do të shkruajë: “Këtu shqiptarët e lartpërmendur kanë një gjuhë të dalluar prej latinëve, grekëve e sllavëve, ata nuk merren vesh fare me popujt tjerë”. Ndërsa prifti i Monakos Guiliem Adae i cili për disa vite kishte shërbyer në Ipeshkvinë e Tivarit dhe Ulqinit, në vitin 1332 shkroi me porosi të papës Gjon (22) XXII, traktatin me titull: (Udhëzim për të kaluar detin), “Directorium ad passagium faciendum”, duke i bërë kështu edhe një relacion Filipit VI Valua, mbretit të Francës, ku jep të dhëna për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Këtu gjejmë edhe fjalinë e famshme që e bëri të njohur në histori: “*Dhe megjithëse shqiptarët kanë një gjuhë krejt tjetër dhe të ndryshme nga latinët, ata gjithë librat e tyre i shkruajnë me germa latine*”. (Raka 1997) Ekzistojnë edhe libra dhe dokumente tjera të ruajtura në Arkivin Sekret të Vatikanit dhe në Bibliotekën Apostolike të cilat janë shkruar në gjuhën greke dhe atë shqipe e që janë në dorëshkrime e të pabotuara, të cilat sipas prof. Moikom Zeqos po përgatiten për botim.

Më pas sipas rendit kohor e kemi *Formulën e Pagëzimit*, 8 nëntor 1462 që peshkopi dhe këshilltari i Skënderbeut, Pal Engjëlli e shkroi për arsye praktike t’u ndihmonte fshatarëve që vinin nga zonat e thella, në kohë dimri për t’i pagëzuar fëmijët në kishë. Fraza ka dy rreshta të shkruara në gjuhën shqipe me germa latine të alfabetit mesjetar dhe qëndron mes një teksti në gjuhën latine. Fjalorthi i Arnold fon Harfit 1497, i shkruar nga një pelegrin bavarez i cili duke udhëtuar për në Jerusalem u ndal në disa qytete shqiptare dhe për nevojat e veta personale shkroi në shqip 26 fjalë, 8 shprehje dhe numrat nga 1 deri 10 dhe nga 100 - 1000 të shoqëruar me përkthimin në gjermanisht. Ndërsa libri më i vjetër (zyrtarisht) që daton, është i vitit 1555 Meshari i Gjon Buzukut i gjetur në Bibliotekën e Vatikanit më 1743 nga Gjon Nikollë Kazazi.

Vlen të përmenden shkrimtarët dhe shkencëtarët shqiptarë të Renesancës evropiane: Leonik Tomeu, nga Durrësi, profesori i parë i filozofisë në Universitetin e Padovës që pati student Nikolla Kopernikun, u laureua me çmimin Erasmus Rotherdamm-i, për erudicionin e tij. Shkrimtarë, shkencëtarë, astronomë, filozofë, mjekë e teologë: Gjin Gazulli, Marin Beçikemi, Marin Barleti, Mikel Maruli, Mihal Artioti, etj.

Vepra të rëndësishme për shkencën e albanologjisë kemi librat e Pjetër Budit, Doktrina e Kërshtenë, Ritualit romak, Pjetër Bogdani, Çeta e Profetëve, në të cilën ndeshemi për herë të parë me atë që mund të quhet gjuhë letrare, veprën e Frang Bardhit, Fjalorin latinisht-shqip, “Apologji për Skënderbeun”, Lekë Matrëngës “E mbësuar e krështënë” etj., të cilat përveç përmbajtjes teologjike kanë edhe vlerë gjuhësore. Shkrimtarët shqiptarë që shkruan me alfabet arab Hasan Zyko Kamberi, Nezim Frakulla, Sulejman Naibi, Muhamet Kyçyky, Zenel Bastari, të quajtur ndryshe edhe shkrimtarë të alamiadës etj.

Rezultatet

Vargu i intelektualëve nga mesjeta e deri sot ka emrat më të ndritur të historisë sonë kombëtare, që me kontributin e dijen e tyre kalojnë kufijtë kombëtarë dhe po fitojnë një vend në hapësirën e më të mëdhenjve. Por në majat e suksesit gjithmonë ka vend të lirë, thotë proverba popullore. Rilindja kombëtare kjo periudhë më e ndritshme e jona që solli një numër të madh veprash si traktate politike-filozofike ashtu edhe artistike, gjuhësore, historike e cila do ta përmbyllë me sukses çështjen e një alfabeti të përbashkët në Kongresin e Manastirit.

Në këto kushte Naum Veqilharxhi ishte i pari që ndjeu nevojën e ngutshme të përhapjes së arsimit në gjuhën amtare për të penguar helenizimin e vendit. “Gjuha amtare, shkruante ai, është faktor i rëndësishëm për zhvillimin mendor të fëmijës dhe për përvetësimin e shpejtë të njohurive të dhëna në shkollë.” (Parathënie e *Ëvëtarit*, 1845). Por si mund të lëvrohej gjuha shqipe pa një alfabet të pranueshëm për shqiptarët myslimanë, ortodoksë e katolikë bashkë? Më 1824 dhe 1825 Veqilharxhi e kishte nisur tashmë punën për një alfabet të tijin me tridhjetë e tre shkronja dhe më 1844 shtypi një abetare shqip prej tetë faqesh.

Ky libër i vogël drejtshkrimi, *Fort i shkurtër e i përdorçim ëvëtar shqip*, u shpërnda në mbarë Shqipërinë e jugut, nga Korça në Berat, dhe me sa duket u prit me shumë entuziazëm. Kjo broshurë u zgjerua deri në dyzet e tetë faqe në një botim të dytë po aq të rrallë në vitin 1845 me titull “Farë i ri abëtor shqip per djëlm nismëtore”. Një kopje e këtij libri, prej kohësh i menduar si i humbur, u zbulua nga Shkëlzen Raça dhe prof. Rexhep Qosja në Bibliotekën Gennadius në Athinë dhe u rishtyp më 1983. Veqilharxhi me veprat e tij nga studiuesit konsiderohet si shtytësi i parë i Rilindjes Kombëtare. (Qosja, 1990)

Kërkesat e lëvizjes sonë kombëtare, që do të fillonte pas 30-35 vjetësh, u paraqitën po nga Naum Veqilharxhi në “Enciklikën” apo “Letërqarkoren” e vitit 1846. Duke u bazuar në rrethanat ekonomike, kulturore e arsimore ku ndodhej Shqipëria dhe shqiptarët në shekullin XIX, Naum Veqilharxhi do të angazhohet për nacionalizmin shqiptar, i cili duhej të kishte specifikën e tij. Ai e përpunoi duke u mbështetur kryesisht mbi gjuhën amtare dhe jo mbi fenë, si vepruan popujt tjerë ballkanikë. Letra që i drejton nipit, Jani Calit, student në Vjenë, më 7 prill 1846, për mendimet, dëshirat dhe optimizmin që kultivon, letra për nga përmbajtja përfaqëson një nga traktatet filozofike, etike e patriotike, ndër më të bukurat të periudhës së Rilindjes. Naumi shpalos thelbin e platformës së tij për rilindjen e kombit shqiptar.

Ai paraqet një pjesë të letrës që nipi grekoman i kish dërguar më parë, e cila do të bëhet shkas që Naumi ta shkruajë Letërqarkoren, për të gjithë djemtë e ditur ortodoksë: “*Xhaxhai tim kërkon të lidhë ato që s’lidhen, të sjellë në formë atë që nuk ka formë, të bashkojë në një tufë, myslimanët fanatikë, të krishterët, ortodoksë supersticiozë, papistët që urrejnë fetë e tjera, për të krijuar një trup homogjen nga kombi shqiptar*” (Veqilharxhi 1978). Ndërsa Naum Veqilharxhi i përgjigjet se shqiptarët kanë ekzistuar bashkë me kombet e tjera dhe shqiptaria përfaqëson thelbin e tij, ndërsa përkatësitë fetare janë karakteristika të fituara më vonë, që mund edhe të ndryshojnë.

Për shkak të thirrjes së tij për bashkim kombëtar dhe hartimit të *Ëvëtarit*, më 1846, u thirr në Stamboll, u burgos në zandan dhe mendohet se vdiq prej një helmimi nga Patriarku Ekumenik i Kostantinopojës. Rilindësit shqiptarë kishin një program të përbashkët për ringjalljen e së kaluarës së lavdishme, si në kohën e Skënderbeut, ata do t’i paraqesin në veprat e tyre artistike, prozaike, filozofike, gjuhësore etj., për ta kryer misionin e tyre ndaj atdheut. Ashtu si në vargjet e Pashko Vasës, kur thoshte: E mos shikjoni kisha e xhamia, feja e shqyphtarit asht shqypitaria (Vasa, 1878).

Ne e dimë që alfabeti i shoqërisë Drita të Stambollit i hartuar nga Sami Frashëri fitoi në këtë konkurs shkronjash, por ky dijetar ishte njëkohësisht edhe babai i gjuhës moderne turke, pasi që hartoi edhe alfabetin e sotëm turk dhe gramatikën e gjuhës moderne të saj, por edhe shumë drama, përkthime dhe Enciklopedinë Botërore në gjuhën turke.

Sami Frashëri arsyet për shkronjat jolatine në Alfabetin e Stambollit i dëshmon me këto fjalë:

Vërtet shkronjat' e llatinishtesë janë aqë të paka, sa jo për gjuhët tënë, që ka kaqë zërëra, po edhe për gjuhërat e Evropësë nuk janë mjaft. Evropianët për të mbushurë ato të pakatë, shkruajnë nga dy shkronja, e i këndojnë të dyja bashkë, po kjo është një pun' e rëndë e e mërzturë. Kësaj i desh gjëndurë një udhë. Përmi këtë shumë njerëz janë menduarë edhe shumë udhëra kanë gjeturë, po nonjë nukë ka qën' e lehtë' e e pëlqyerë sikundrë duhetë. Këtë herë që u duk nevoj' e madhe për të shkruarët e të gjuhësë sanë, këtë her' u gjënt edhe një udhë shumë e lehtë' edhe shumë e mirë: Muarmë të njëzet e pesë shkronjatë llatinishte, u dhamë cave nga ato një këndim pas nevojës së gjuhësë sanë, edhe nga të njëmbëdhjetat' e tjera ca i bëmë prapë nga ato shkronja, duke ndërruarë pak fytyrënë, ca i muarmë nga greqishtja, që është' edhe ajo një nga motërat e vjetëra të gjuhësë sanë, si edhe llatinishtja. (Frashëri, 1978). Samiu bashkë me Naimin, Koto Hoxhin përgatitën Alfabetaren e Stambollit që u botua më 1879.

Një alfabet i vetëm do të thotë, një unitet kombëtar që ishte qëllimi i rilindësve, të njëjti kombi ynë nga të tjerët, sepse Perandoria Osmane kishte bërë ndarjen fetare-etnike dhe ndarjen në katër vilajete që çonte në copëtimin e tokave shqiptare, si një etni multifetare. Shtrohet pyetja me sa alfabete u shkrua shqipja para Kongresit të Manastirit? Sipas studiuesit Robert Elsie krahas alfabeve të huazuara, interes paraqesin alfabetet origjinale dhe ai ka gjetur dhjetë alfabete të këtilla. Një ndër to e hasim në “Dorëshkrimin Elbasanas të Ungjijve”, që sipas Elsie-t, me shumë gjasë është vepra e Gregorit të Durrësit, një figurë e madhe e kësaj periudhe, ai është një dorëshkrim i vogël dhe i vetëm që ruhet në Arkivin e Shtetit në Tiranë.

Ky studiues në kapakun e dorëshkrimit të Ungjijve vërejt një vizatim me dymbëdhjetë fjalë të shkruara me një alfabet të ndryshëm nga ai i dorëshkrimit, i krijuar nga njëfarë Todhri Haxhifilipi (1730-1805) nga Elbasani. Në shek. XVII Papa Totasi, mendohet se është autor i një dorëshkrimi, i cili për pamundësi identifikimi të saktë u quajt, “Anonimi i Elbasanit”, dorëshkrimi ka 58 faqe dhe është shkruar me një alfabet origjinal të autorit. (Zajmi, 1972). Faza e mallkimit (1483), është konsideruar si dokument i dytë i gjuhës shqipe, është gjetur në një komedi latine me titull “Epirota”, të shkruar nga Tomazzo da Mezzo, “Dremburi të cloftë gola” që d.m.th., (tremburë të kloftë goja), fraza është shkruar nga një i huaj që nuk e njohte shqipen. (Raka, 1997)

Alfabeti i Todhrit u zbulua nga Johan Georg fon Hani (1811-1869), konsulli austriak në Janinë dhe studiues i albanologjisë. Një tjetër është ai i të ashtuquajturit Kodeksit të Beratit. Ky dorëshkrim prej 154 faqesh, është vepra e të paktën dy shkrimtarëve dhe u hartua midis viteve 1764 e 1798. Dorëshkrimi lidhet me njëfarë Kostë Berati. Sipas Robert Elsie-t, në faqen 104 gjejmë dy radhë të shkruara shqip me një alfabet origjinal prej 37 germash të ndikuara, siç thuhet, nga glagolishtja. Kemi të dhëna edhe për një alfabet tjetër në Gjirokastër nga fundi i shek. XVIII dhe fillimi i shek. XIX, i Veso beut me një sistem grafik prej 22 germash që e zbuloi dhe botoi Hahni. Një tjetër alfabet është nga jugu i Shqipërisë i Jani Vellarait (1771-1823) që gjuhën shqipe e shkroi me këtë alfabet origjinal prej 30 shkronjash me bazë latine e greke.

Një vepër e rëndësishme është edhe Gramatika e gjuhës shqipe nga Françesko Maria da Leçe misionar apostolik i Vatikanit për Shqipërinë në vitin 1692, vepra u botua në 1702, në Romë. Ndërsa mikja e Shqipërisë dhe shqiptarëve Edith Durham, e cila studioi, doket, zakonet, traditat, etnografinë, antropologjinë dhe cilësitë karakteristike të jetës shpirtërore e sociale të shqiptarëve, do të jetë përjetësisht mike e madhe dhe do të mahnitet nga bujaria e tyre.

Me sa kam mësuar deri tani, ajo çka Shqipëria kërkon vërtetë është pavarësi dhe njohje prej Europës... Në mbarë vendin, njerëz nga të gjitha klasat nxitojnë të më shpjegojnë shpresat dhe frikën e tyre për atdheun, dhe lutën që anglezët të njohin ekzistencën e tij. Më përshëndetën si shpëtimtare. Isha krejtësisht e papërgatitur për një gjë të tillë dhe u tmerrova". <http://koha.net/?id=4&l=5520>. Ajo do të jetë ndihmëtare dhe mbrojtëse e madhe e shqiptarëve dhe kjo nuk ka të bëjë me interesa të veçanta të saj, ajo u mahniti nga bujaria, mikpritja, besnikëria dhe korrektësia e shqiptarëve për mikun. Kjo sigurisht është rezultat i vlerave dhe kodit kanunor aq i shenjtë dhe i respektuar në Veri e Malësinë e Madhe, ku ajo kaloi kohën më të madhe në këto vise.

Një rol të jashtëzakonshëm ka luajtur edhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit, 1878-1881, e cila në krye me Abdyl Frashërin, Sulejman Vokshin, etj, themeloi Komitetin qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë në Konstantinopojë me synimin që shqiptarët të fitonin një farë autonomie përbrenda Perandorisë Osmane. Pas luftës ruso-turke dhe fitores së rusëve e serbëve mbi Perandorinë Osmane më 31 janar Konstantinopojë 1878 dhe Traktatit të Shën Stefanit më 3 mars 1878, u aneksua një pjesë e madhe e territorit shqiptar nga shteti i porsaformuar autonom bullgar dhe nga mbretëritë e Malit të Zi dhe Serbisë.

Në këto rrethana Abdyl Frashëri do t'i përvishet punës për organizimin e shqiptarëve në përpjekjet për pavarësi, pasi që traktati i Shën Stefanit, Kongresi i Berlinit më 13 qershor 1878, kishte konfirmuar pavarësinë e Rumanisë, Serbisë, Malit të Zi si dhe qeverisjen autonome të Bullgarisë, ndërsa çështjen e shqiptarëve e konsideruan, një "çështje gjeografike", ata nuk u njohën madje as si popull. Më 10 qershor 1878 atdhetarët u mblodhën në Prizren për të hartuar një platformë politike - Lidhjen e Prizrenit. Kjo nismë në fillimin e saj pati përkrahjen e qeverisë osmane. Këtë kuvend e hapi Abdyl Frashëri, si përfaqësues i Komitetit qendror nga Stambolli. Vendimet e Lidhjes së Prizrenit, nën emërtimin Kararnameja u miratuan dhe u nënshkruan nga dyzet e shtatë bejlerë shqiptarë më 18 qershor 1878. Ato ishin:

1. Mospranimi për t'i dorëzuar territore Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë;
 2. Kërkesa për të kthyer të gjitha tokat me popullsi shqipfolëse të aneksuara nga Serbia dhe Mali i Zi;
 3. Autonomia brenda Perandorisë; dhe
 4. Ndërprerja e thirrjes nën armë dhe e taksave nga qeveria qendrore në Stamboll.
- (Elsie, 1997).

Në vitet 1860 Konstantin Kristoforidhi me ndihmën e Aleksandër Tomsonit, këtij poliglotti skocez që studioi në Universitetin e Edinburgut, nisi të punojë për Shoqërinë Biblike Britanike e Botërore, për të cilën ai përktheu Dhjatën e Re në variantin gegërisht (1872 me alfabet latin) dhe në variantin toskërisht (1879 me alfabet grek) si dhe disa libra të Dhjatës së Vjetër. Këto përkthime do t'i ndihmojnë gjuhës letrare moderne dhe i dhanë atij titullin e 'babait të gjuhës shqipe'. Kristoforidhi gjithashtu shkroi një gramatikë të gjuhës shqipe në gjuhën greke Stamboll 1882 dhe, hartoi një fjalor shqip-greqisht në Athinë më 1904.

Testamenti politik i De Radës i botuar më 30 shtator 1902 është një kontribut tjetër për alfabetin e gjuhës shqipe, si dhe gjithë rilindësit që me veprat e tyre, letrare - artistike dëshmuan për një traditë të hershme të shkrimit shqip, edhe pse me alfabete të ndryshme, kjo përforcon bindjen se gjuha shqipe është shkruar shumë herët, argument për këtë janë fjalorët të cilët dëshmojnë një etimologji të fjalëve arkaike shqipe, siç është Fjalori 1300 faqesh i studiuesit holandez Alwin Klockhorst. Ndërgjegjja e përgjithshme është më e saktë se ajo individuale, ashtu sikurse edhe kjo ndërgjegje mund edhe t'i ndryshojë e hiperbolizojë disa fakte, por ajo mbetet përsëri më e besueshme.

Dhimitër Kamarda më 1864 botoi (Sprovë e gramatologjisë krahasuese mbi gjuhën shqipe), që përfaqëson edhe një gur të çmuar të gjuhësisë dhe kulturës shqiptare, ashtu sikurse edhe princesha rumune me origjinë shqiptare nga dera e Gjikaive Dora D'Istria ose Elena Gjika, që me veprën e saj *Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore* botuar më 1866 dha një kontribut të çmuar për kulturën shqiptare. Rilindja Kombëtare ka emra të shquar që kontribuan madje edhe sakrifikuan gjithçka për të ruajtur gjuhën, kulturën dhe identitetin, por këtu kam veçuar disa emra puna e të cilëve lidhet ngushtë me Rugën e Shkronjave deri në përfundim të Kongresit të Manastirit dhe arritjes së një marrëveshjeje për një alfabet unik.

Nga 1-10 maj 1902 Mjeda mori pjesë në Konferencën e Parë të Ipeshkvijve Shqiptarë në Shkodër, e cila vendosi ta aprovojë alfabetin e Mjedës për tekstet shkollore të Shqipërisë së Veriut. Më 2 gusht 1902 në Hamburg u mbajt Kongresi XIII Ndërkombëtar i Orientalistëve ku morën pjesë 750 shkencëtarë nga e gjithë bota, i cili zhvilloi punimet nga 5-9 shtator 1902, Ndre Mjeda mbajti ligjëratën “Mbi shqiptimin e qiellzoreve ndër dialektet e ndryshme shqipe”, *konferenca aprovoi që në sesionin e parë dialektin tim me shenja diakritike, atje vendosa lidhje me shumë albanologë dhe u ktheva në Shkodër më 10 tetor 1902, shkruan ai në ditarin e tij.*

Kur kthehet në Shkodër arrestohet nga Shaqir pasha më 11 tetor 1902, me urdhrin direkt nga sulltani dhe duhej të gjykohej në Stamboll. *Ndërhyn menjëherë qeveria austro-hungareze në bazë të prote-kultit si mbrojtëse e katolikëve në Shqipëri, e cila e kërcënon sulltanin se do t'i dërgojë luftanijet në portet e Stambollit. Bëhen disa mbledhje qeverie në Stamboll e Vjenë dhe në fund qeveria turke tërhiqet. Në momentin e liritimit të Mjedës Shaqir pasha i thotë, “Nuk të takon ty si prift me u marrë me politikë”, ndërsa Mjeda i përgjigjet “Dashnia për atdhe nuk është politikë”. Ndërsa në procesverbalin e lëshuar nga qeveria Shaqir pasha do të lexojë “Mëshira e madhe e portës së lartë më detyron me dhan një urdhër të padëshirum, lirone qafirin, nuk tremet qeveria nga bejtexhia”.* <https://www.youtube.com/watch?v=tNtrZKyxjr0>

Në ditarin e tij Ndre Mjeda do të shkruajë: *“Të gjithë erdhën në Manastir për tu dalë zot alfabeve të veta, u mblodhën në shtëpinë bujare të Gjerashim Qiriazit dhe aty punuam tre ditë e tre netë pa dalë prej shpie, por më kot siç po e shihshim punën ne do të ndaheshim në shpijat tona, pa krye detyrën ndaj atdheut. Dikush duhej të tërhiqej, mendova gjithë natën dhe vendosa të tërhiqesha une. Kështu u hap rruga për alfabetin e Shoqërisë së Stambollit dhe Shoqërisë Bashkimi të Shkodrës, që me disa ndryshime u pranua. Në nesër në mbledhjen e radhës çdo gja u zgjidh vetiu. E shoh të obligueshme tërheqjen e Shoqërisë Agimi me bindjen e ndërgjegjes se këtu është fjala për interesa kombëtare më shumë se gjuhësore e politike, e ne kemi nevojë për pajtim kombtar”* (Mjeda, 1982), tha Mjeda para anëtarëve të Komisionit. Kongresi i Manastirit i mbajti punimet nga 14-22 nëntor 1908 dhe mbetet akti i pajtimit të shqiptarëve që duke vendosur për alfabet të përbashkët i hapën rrugë aktit madhështor të Pavarësisë.

Diskutimi dhe përfundimi

Një ndër iniciatorët e Kongresit të Alfabetit, që ka një meritë të madhe kombëtare është pa dyshim Gjergj Fishta. Pasuria gjuhësore dhe tradita e kultivimit të saj, ndihmoi që ajo të mbetet e pacenuar nga influksionet e huaja. Bukuria verbuese e gjuhës sonë, na ndihmon të fluturojmë me krahët e Zanës në Lahutën e Malcis, të jemi me Tringën e Malsisë kur mbron nderin dhe pragun e shtëpisë nga cubat malazez, të presim me ankth vendimet e Kongresit të Berlinit, Konferencës së ambasadorëve në Londër, ku u “end fati i Shqipërisë”, duke vëzhguar luftërat e kreshnikëve të Malcis: Marash Uç e Çun Mula, Oso Kuka e Dedë Gjo’ Luli me cubat e Malit të Zi, në Vraninë e Cetinë.

Kontributi i Fishtës është i paçmueshëm, si nga veprimtaria letrare, ashtu edhe atdhetare. Kryetar i shoqërisë Bashkimi, ai hartoi alfabetin latin për gjuhën shqipe i cili do t'i përfaqësonte të gjithë tingujt e saj. Poezia *Gjuha Shqipe*, e thurur me gjallëri ritmike, ngarkesë emocionale, figura të gjalla e të goditura, patosi solemn, ndjenjat e sinqerta dhe mendimi i mprehtë e karakterizon lëndën poetike të Gjergj Fishtës, gjuha ky themel identiteti, simbol i shqiptarëve, nuk mund t'i ikë penës së poetit, ai i thur vargje që ngjiten si spirale drejt qiellit, si testament i vazhdimësisë së kombit, me theks të spikatur për ngritjen e vetëdijes kombëtare.

Bota poetike e tij lundron në një frymë atdhedashurie, ku ndihet dashuria për tokën, njerëzit, ku jep porosi për shkundjen e përfytyrimeve që janë të huaja e të bezdisshme për të, ai jeton në një ekstazë luftarake, forcon gjymtyrët, gjuan, përzë e tremb ujqërit, s'përkulet para armikut dhe kështu ecën përpara me krenari...Asgjë s'e ndal nga ideali që e ka pushtuar të tërin. Kjo poezi është një pasqyrë besnike e gjallërisë komplekse, e vitalitetit të gjallë e fisnik për ti ruajtur ato cilësi origjinale, për ta përmbushur misionin e tij! Poezitë e tij janë të kapluara nga një lirizëm i çiltër frymëzues, që shprehen me imazhe të shndritura për të kaluarën që është e sotmja por edhe e ardhmja.

*Pra shqyphtar, çdo fes q'i tjin
Geg e Tosk, Malci e qyteta
Gjuhën tuej kur mos ta lini
Mos ta lini sa t'jet jeta
Por për te gjithmonë, punoni
Pse sa t'mbani gjuhën tuej
Fisi juaj, vendi e zakoni
Kan me ju mbajt, larg kambët t'huej.*
(Fishta:2002)

Ky kongres pati gjithsej 32 delegatë me të drejtë vote, që përfaqësonin 23 qytete, shoqëri dhe klube dhe 18 delegatë të tjerë, pa të drejtë vote. Kryetar i Komisionit ishte Gjergj Fishta, nënkryetar: Mit-hat Frashëri, sekretar: Luigj Gurakuqi, anëtarë : Ndre Mjeda, Bajo Topulli, Sotir Peci, Gjergj Qiriaz, Shahin Kolonja, Parashqevi Qiriaz, Grigor Cilka, Hilë Mosi, Thoma Avrami, Fehmi Zavalani, Nyzhet Vrioni, Bajo Topulli, Phineas Kennedy - vëzhgues i kongresit, Sotir Peci, Shahin Kolonja, Dhimitër Buda, Mihal Grameno, Sami Pojani, Filomena Bonati, Taqi Buda, Petro Nini Luarasi.

Pati përkrahës të alfabetit arab për gjuhën shqipe si myftiu i vilajetit të Manastirit Rexhep Voka nga Shipkova e Tetovës, por kjo nuk u përkrah sepse ideja e një alfabeti të përbashkët ishte të mos ketë ndikim dhe prapavijë fetare. Një rol të rëndësishëm në çështjen e alfabetit kanë pasur edhe klerikë të tjerë si Hafiz Ali Korça, i cili për figurën e Gjergj Fishtës do të shkruajë: “*Me këmbënguljen e tij gjuha jonë e lashtë gjeti sintetizim të shkruar...Nuk kam si t'a harroj me sa dashuri më përqafoi dhe më përgëzoi, (kur qemë takuar shumë vite më vonë me Fishtën), që në demonstratën e madhe të Korçës më 1910 kundër shkruarjes së gjuhës shqipe me shkronja arabe, unë bekova shkronjat latine të abecesë shqipe të Kongresit të Manastirit dhe thashë edhe një lutje për to*”. Pra siç duket edhe pas Kongresit të Manastirit ka pasur elementë të ndikuar nga perandoria për të futur përçarje dhe ngatërresa në lidhje me alfabetin latin dhe përmbysjen e vendimeve të Kongresit të Manastirit.

Ndërsa më 1 shtator 1916 në Shkodër ngrihet Komisia Letrare e Shkodrës, që në të vërtetë është Akademia e parë shqiptare, me anëtarë aktivë dhe bibliotekë të pasur. Me sugjerimin dhe përkrahjen e Austro-Hungarisë dhe sidomos konsullit të saj në Shkodër, August von Kral, i cili do të bisedojë me Gjergj Fishtën, Mati Logorecin, Luigj Gurakuqin, Ndre Mjedën që të rregullojnë

çështjen e drejtshkrimit shqip dhe botimin e librave. Në mbledhjen e parë themeluese morën pjesë gjashtë vetë: Luigj Gurakuqi, At Gjergj Fishta, Sotir Peci, Dom Ndre Mjeda, Mati Logoreci, dhe At Ambroz Marlaskaj. Pjesëmarrës dhe të ftuar të tjerë të KLSH që morën pjesë në mbledhjet e mëvonshme qenë dr.Gjergj Pekmezi, Hilë Mosi, Anton Paluca, Hafiz Ali Korça, Aleksandër Xhuvani, Maksimilian Lamberci, Rajko Nahtigal, Emzot Vinçens Prenushi, Sali Nivica, Josif Haxhimima dhe Luigj Naraçi. Kjo Komisi vazhdoi punën aty ku e la Kongresi i Manastirit, ajo vazhdoi me aktivitetin e vet edhe pasi shpërtheu Lufta e Parë Botërore e deri më 1972, ku e përmbylli me Kongresin e Drejtshkrimit Shqip. Janë tre ngjarje të rëndësishme mbi të arriturat e standardizimit dhe evoluimit të gjuhës shqipe: Komisia Letrare e Shkodrës 1916, Konsulta Gjuhësore e Prishtinës e vitit 1968 dhe Kongresi i Drejtshkrimit më 1972 në Tiranë. (Raka, 1997).

Në nëntor të vitit 1884, një djalë i ri shqiptar, me ëndrrën për të ndryshuar kombin, nisete me një karrocë që shkonte për në Korçë, pa e ditur se rrugës i kishin zënë pritë. Në librin Pengu i kaçakëve, Gjerassim Qiriazit rrëfen historinë e vërtetë të rrëmbimit të tij dhe ato që ngjanë gjatë atyre muajve sa që peng i kaçakëve. Ishte ai kalvar i dhimbshëm që e nxiti atë për t'i nxjerrë bashkatdhetarët e vet nga errësira. Më 12 prill 1865 Kristoforidhi i shkruan Aleksandër Tomsonit, nga Tunizia se i pranon kushtet për ta përkthyer Biblën në gjuhën shqipe, por që t'i përshtateshin tingujt në gjuhën shqipe duhej një alfabet i posaçëm.

Profesori i Universitetit të Berlinit Karl Lepsius, kishte hartuar një alfabet me shkronja latine, disa shkronja greke dhe disa shenja diakritike që ky alfabet t'i paraqiste plotësisht tingujt e shqipes. Rajdeli gjeti një djalë të ri të arsimuar nga Shkodra, Nikolla Xhuvani Seregjin, i cili në maj 1865 shkoi në Stamboll t'i ndihmonte Kristoforidhit dhe në qershor të këtij viti ata filluan punën për përkthimin e Biblës. Gjerassim Qiriazit, (2016), *Captured by Brigands for Albanian and Protestant Studies*.

Një ndër vendimet e Kongresit të Manastirit ishte ngritja e Shtypshkronjës Shqipe në Manastir nën drejtimin e Gjergj Qiriazit, e cila u bë e njohur anembanë vendit si shpërndarëse e librave dhe gazetave shqipe. Por shpejt qeveria osmane i mbylli të gjitha shtypshkronjat. Më 1911, Xhon Hoxhson, përfaqësuesi i Shoqërisë Biblike të Kostandinopojës, raportonte: *“Të gjitha shkollat shqipe janë mbyllur pa pikë mëshire, kurse përpjekjet ngulmuese për ndalimin e gjuhës dhe zhdukjen e letërsisë shqipe nuk kanë reshtur kurrë. Gjendja e rëndë politike mund të marrë flakë nga çasti në çast. Tashmë shqiptarizmi kishte shpërthyer dhe nuk do ndalej më”!* <https://www.kosova-sot.info/dossier/167573//>

Rëndësia e shkrimtarëve, klerikëve të mesjetës, rilindësve dhe atyre që pasuan, ishte dhe do të mbetet e jashtëzakonshme, ajo është një gjurmë e pashlyer dhe e çmuar e kulturës sonë, ata do të mbeten, atdhetarët, luftëtarët, poetët, poliglotët, filozofët dhe arkitektët e kulturës shqiptare para dhe pas shpalljes së Pavarësisë. Ata patën vetëdijen e plotë për botën shkencore e artistike që po krijonin dhe e paraqitën atë me një unitet kompakt, pavarësisht se epoka në të cilën krijuan dhe punuan nuk që e gatshme ose e qëlluara, për ta kuptuar qëllimin, mundin, energjinë dhe vështirësinë e punës së heronjve të heshtur. Veprat e tyre sot fatmirësisht po mblidhen dhe studiohen, si thesar i fshehur nën peshën e shekujve.

Ata e bartën realitetin në veprat e tyre duke dhënë mendime shkencore me shembuj e argumente dhe duke e ndërlidhur atë me thënie të dijetarëve të mëdhenj të botës, duke krijuar në këtë mënyrë, universin e tyre origjinal. Sot studiuesit më seriozë botërorë e vendosin shqipen si proto gjuha evropiane, një ndër më të vjetrat në botë, si historiani Keneth Harl, Wilhelm Obermuller, Thunmann, Xylander, Markiano, Hahn, etj.

Referencat

- [1]. Zajmi, Yll, (1972), *Antologji e letërsisë së vjetër shqipe*, Rilindja, Prishtinë.
- [2]. Grup autorësh, (1972), *Historia e popullit shqiptar*, Prishtinë.
- [3]. Raka Fadil, (1997), *Historia e shqipes letrare*, Blendi, Prishtinë.
- [4]. Elsie, Robert (1997). *Histori e Letërsisë Shqiptare*, Dukagjini, Pejë.
- [5]. ELSIE, Robert, *Dictionary of Albanian Literature*. (Greenwood, New York, Westport CT & London 1986) 192 pp.
- [6]. Fishta, Gjergj, 2002, *Anzat e Parnasit*, Fan Noli, Tiranë.
- [7]. Pashko, Vasa (1978), *Vepra*, Rilindja, Prishtinë.
- [8]. Frashëri, Naim(1978), *Istori e Skënderbeut*, Rilindja, Prishtinë.
- [9]. Frashëri, Sami, (1978), *Shqipëria çka qenë, ç'është e çdo të bëhetë*, Rilindja, Prishtinë.
- [10]. Mjedja, Ndre, (1982), *Vepra*, Rilindja, Prishtinë.
- [11]. Qosja, Rexhep, (1982), *Historia e Letërsisë Shqipe, Romantizmi I, II, II*, Rilindja, Prishtinë.
- [12]. Gjasim Qiriazhi, (2016), *Captured by Brigands* Institute for Albanian and Protestant Studies.
- [13]. *Revista Studime albanistike*, (1979), Rilindja, Prishtinë.
- [14]. *Indoeuropean Language*, (2107), edited by Mate Kapovic, Routledge, London.
- [15]. Kosova sot online (2017) : Kongresi i Manastirit Abecetë origjinale shqiptare, si u krijuan! 26 janar 2017 nga: <https://www.kosova-sot.info/dossier/167573//>
- [16]. Andrra e jetës nga Ndre Mjeda (21.08.2015), nga <https://www.youtube.com/watch?v=tNtrZKyxjr0>